



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 45220

Më: 23 prill 2025

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 23 prill 2025 në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:05 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj, Karanfil Haxhillari, Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj, Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi – Nënkryetar i Komunës, Gjafer Ponik nga DEF, Bashkim Rakaj nga DPMS, Arbër Krasniqi – Asistent i Kryesueses, përfaqësuesi i OSBE si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Atëherë po besoj që jemi gati me filluar? Shumë të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar nënkryetar, përshëndetje për mediat, për përfaqësuesit e OSBE-së që na kanë nderuar edhe sot, faleminderit që jeni këtu. Për sot, siç jeni të njoftuar kemi ftuar mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa, prezent jemi të gjithë anëtarët, domethënë nëntë anëtarë të komitetit, dhe për rend dite i kemi këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vitin 2025;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Prizrenit për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-212080 të datës 15 dhjetor 2016 – zonave të Qarkullimit Publik në Komunën e Prizrenit;
5. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025.

Antigona Bytyqi: Atëherë po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Antigona Bytyqi: Kemi këtu një përfaqësues nga Drejtoria e për Mirëqenie Sociale. Pra, meqë e kemi tash mungesë të drejtorit. Po Bashkimit po ja kalojmë fjalën.

Bashkim Rakaj (DPMS): Së pari ju kërkojmë ndjesë për vonesën sepse s'kemi arritur në kohë me ju sjellë dokumentacionin për ata që kemi me e propozu, duke marrë parasysh se kemi pasur lëvizje të ndryshimit politik të drejtorit, kështu që kemi stagnu. Ne po propozojmë me kaluar në kuvend, janë dy vendime, një vendim paraparak për dhenien në shfrytëzim të një prone komunale për ndërtimin e Qendrës së Autizmit, edhe një vendim tjetër që besoj që ka me u bë pjesë e rendit të ditës për miratimin e komisionit. Po mundohem me ja u shpjegu pak a shumë kush është qëllimi i këtij dhe në qoftë se keni nevojë për pyetje unë edhe ju kërkoj ndoshta s'jam shumë me i updejtuar me këtë situatën politike. Nevojat për ndërtimin e një qendrese apo një shtëpie që ka me i trajtu fëmijët e të rriturit autik është imediate, arsyeja e vonesës deri tash që ka ndodhur që s'kemi arritur me i kriju ndoshta komuna edhe nëpër të gjitha territoret e Kosovës, kanë qenë të ndryshme. Një prej faktorëve kryesorë se nuk kemi pasur një Udhëzim Administrativ, një rregullore se qysh kanë me u rregulluar dhe me funksionu këto qendra. Fatmirësisht tash e kemi një rregullore të tillë, një plan të tillë. Duke marrë parasyshë koston financiare dhe vështirësitë e ndërtimit edhe vënies në funksion të Qendrës Autizmit, ne si DPMS kena mendu me gjetë një pronë edhe me provu me gjetë një thirrje publike me pa a ka interes prej organizatave të ndryshme që ofrojnë shërbime për trajtimin e fëmijëve dhe të rriturve autik për me mundur me na ndërtuar qendrën dhe me funksionalizu. Kështu që kjo është ideja, prona është në njësinë katastrale 11048-17 që bie në Tusuz te pjesa ku është ndërtuar çerdhja dhe QKMF-ja, a pjesa përballë. Në bazë të standarteve ne kemi vlerësuar që i plotëson kushtet, i plotëson kriteret për ndërtimin e objektit edhe ofrimin e shërbimeve. Pastaj futen edhe disa standarte të tjera që qendra duhet me kanë periferike, duhet me qenë afër institucioneve, për shembull aty e kemi të mirë se e kemi QKMF-në, e kemi çerdhën e kemi qendrën për punë sociale, është tuj u përgatit edhe shtëpia emergjente për mbrojtjen e fëmijëve dhe si me thënë inkorporohet me institucionet e ofrimeve të shërbimeve sociale që janë të gjitha aty. Nga një informacion mundet me ja dhënë, ju kërkoj ndjesë që s'ja u kam qu me e-maill me ja hedhi një sy. Në qoftëse keni mundësi me mbështet edhe me hedh në votim pastaj.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Bashkim. Dikush tjetër rreth rendit të ditës a keni me e marrë fjalën? Po urdhno Karanfil.

Karanfil Haxhillari: Jo veç po du me e shtu këtu që ju vetë e përmendët sa e rëndësishme është ndërtimi i një qendre autike edhe si fenomen na në Prizren si qendra e dytë më e madhe në Kosovë kemi mungesë të një qendre të trajtimit të këtyre personave. Por që gjithë kjo rëndësi e madhe a e din me ardhur AD-HOC në këtë formë më vertetë është pak sepse po i tejkalohej serioziteti, për një çështje kaq serioze po i hiqet serioziteti. Absolutisht unë mendoj që ne duhet të jemi për ndërtimin e kësaj, por që aty tash sa hapësirë ka komuna? sa sa do të nxenë sepse autikët e kanë nevojë për një hapësirë më të madhe, nuk janë thjeshtë një kategori, bile ata janë më të mirë se na normal që jemi për, por që a i plotëson kriteret me qenë sepse aty qenka një çerdhe një QKMF edhe sa metra katrorë do të ndahen për këtë për këtë objekt?

Adem Shabanaj: 1415 metër katror, 14 ari..

Kujtim Gashi: 14 ari.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Karanfil. Atëherë në qoftë se nuk kemi edhe dikush tjetër diçka, po e hedhim në votim këtë propozimin e ri që u bë për me hy në rend dite.

Dafina Alishani: Kryesuese a bënë edhe diçka?

Antigona Bytyqi: Po urdhëro.

Dafina Alishani: A është bërë një farë analize sa qytetarë kemi që janë autik?

Bashkim Rakaj (DPMS): Analizë mbi rrjetëzimin social, ajo që është e mirëfilltë që quhet rrjetëzim social me kategori të veçantë, personat autik nuk kemi arritur me bë as përmes drejtorisë as përmes një organizate sepse është projekt i madh edhe i vështirë. Por ne kemi statistika, statistikë të përafërta. Në gjithë Kosovën janë rreth 2.400 që marrin shërbime të drejtpërdrejta, ndërsa në Prizren shërbime të drejtpërdrejta që marrin një organizatë ka kapacitet jo më shumë se 20 persona, organizata që merret me shërbime të autikëve. Ambientet ku i shfrytëzojnë këto aktivitetet është shumë i vogël.

Kujtim Gashi: Jo për shërbimet, numri në Prizren a dihet përafërsisht?

Bashkim Rakaj (DPMS): Numri në Prizren përafërsisht që marrin shërbime te Qendra për Punë Sociale dhe jo të organizatë që ofrojnë shërbime të drejtdrejta është 57, por kjo nuk domethënë që është numër i sigurt sepse ka raste kur nuk don me i përfituar shërbimet e shtetit të formave të ndryshme, qoftë përmes pensioneve që japim përmes Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale edhe nuk është numri i saktë. Prandaj nuk është bërë një artëzim i tillë ajo vlerësimi që po kërkon.

Dafina Alishani: A s'ka komuna kapacitet vet me e bë këtë objekt edhe vetë me e menaxhu?

Bashkim Rakaj (DPMS): Është pyetje me vend, kapacitet ka, mundësitë janë, por që ju e dini investimet e mëdhaja janë investime afatgjate. Duke marrë parasysh politikat e përgjithshme të shërbimeve sociale në vend edhe në botë, orientimi i blerjes së shërbimeve nëpër organizata joqeveritare është më efikas edhe më i lehtë, edhe investimi po mendoj, qysh me thënë procedurat bëhen pak më shpejtë. Për shembull, shteti nuk ka kapacitete shumë të mirëfillta për trajtimin e fëmijëve dhe të rriturve autik, ndërsa kemi organizata shumë të specializuara që kanë rreth 20 vjet që ushtrejnë aktivitetin në forma të tilla. Ne po provojmë me bë një thirrje publike a ka një organizatë të interesuar që mundet me na bë këtë lloj investim edhe shërbim, kjo nuk është e pamundur.

Dafina Alishani: Sa organizata janë që merren me këtë punë në Prizren edhe në Kosovë?

Bashkim Rakaj (DPMS): Ka shumë organizata në Kosovë, në Prizren është shoqata e autizmit, domethënë shoqata e autizmit është organizatë nacionale, por që ka degët e veta të shtrime nëpër të gjitha komunat. Kështu që është një prej organizatave serioze që ofron shërbimet, por kjo nuk do të thotë që s'ka dhe organizata të tjera që ofrojnë shërbime mbështetëse për personat autik.

Antigona Bytyqi: Egzona a dashte me marrë fjalën?

Egzona Hoxhaj: Po, dashta me u ndërlidhë se Bashkimi e din shumë mirë që nuk muj pa u ndërlidh këtu për shkak që ka vite që merrna me shërbimet sociale dhe me punën e organizatave. Pyetja e Dafinës qysh e tha dhe Bashkimi numër të saktë sa persona me aftësi të kufizuara, në këtë rast sa persona autik janë në Kosovë, nuk ka për shkak që edhe regjistrimi i fundit i popullsisë nuk na ka ndihmuar organizatave që me marrë të dhëna në teren se sa është numri për të gjitha llojet e personave me aftësi të kufizuara, Për shkak që ai pyetësori nuk ka pasur rubrika të veçanta dhe pse organizatat e aftësisë kufizime të gjitha bashkë e kanë bërë një dokument edhe kanë kërku prej Agjensionit të Statistikave të Kosovës me u përfshi. Unë Bashkim, se ne e kena diskutu shumë herë ti e din që kërkesë e kamoshme e krejt organizatave, sidomos në Prizren është që me u ndërtu një objekt që të gjitha organizatat me i ofru shërbimet e veta në komunën e Prizrenit aty sepse nuk është vetëm organizata e autizmit, por janë të gjitha organizatat edhe Hendikosi që është një prej organizatave më të mëdhaja që vepron në komunën e Prizrenit edhe organizata e Syndrom Down kanë probleme me hapësirën për shkak që nuk kanë hapësira të mjaftueshme për me ju ofru shërbimet e veta. Ndoshta është mirë me kqyr mundësinë çka mujna me kërku mbështetje edhe prej institucioneve qëndrore që me gjetë një hapësirë më të madhe me bërë një objekt qysh funksionojnë edhe në komunën në komunën e Gjilanit për shkak që edhe harmonizimi mes organizatave është shumë më i mirë për shkak që na e dimë që personat me aftësi të kufizue ose me autizëm përpos që marrin shërbime te organizata e autizmit marrin shërbime dhe të Hendikosi sepse Hendikosi ofron dhe shërbime të tjera që nuk ka mundësi me i dhënë kjo organizatë. Por gjithsesi autizmi e ka shumë të nevojshme me ju siguruar hapësira se tash për tash unë e di në çfarë kushte veprojnë, me një ambient krejt mykun që janë për një mend në gjendje shumë të mjerueshme.

Antigona Bytyqi: Urdhëro Bajram.

Bajram Kastrati: Prona e paraparë a është në bazë të një projekti paraparak, do të thotë a e keni bërë një projekt apo veç është pronë që është për momentin e lirë 14 ari? A mundet me u rritë si pronë?

Bashkim Rakaj (DPMS): Është pyetja e saktë, është pyetje me vend. Prona me u rritur nuk mundet, një projekt paraparak nuk e kemi bërë sepse ne po shfrytëzojmë këtë mundësi që Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale me na kriju që mekanizmi ligjor me na dhënë pronën, me na leju me dhënë pronën në shfrytëzim, pastaj paraparakisht kena me bërë një thirrje publike. Thirrja publike ka me u bërë në bazë të standarteve, tash i kemi standartet, kush janë për themelimin dhe ndërtimin e qendrës për kategoritë specifike, kategoria e tillë se po flasim për autizmin, edhe thirrja publike dhe ndërtimi i objektit ka me u bërë në bazë të standarteve.

Bajram Kastrati: A mundet me u zgjeruar prona pastaj? Nëse nuk a projekt ne mundemi me dhënë si pronë, por nëse nuk i plotëson kushtet për ndërtimin e një objekti një projekti.

Bashkim Rakaj (DPMS): I plotëson.

Antigona Bytyqi: Dëgjo, Bashkimi e propozoj, nëse hyn në rend dite ne e kemi mundësinë pastaj edhe si pikë e fundit e rendit të ditës me diskutu përsëri.

Kujtim Gashi: Veç deshta me thënë që bëhet fjalë për një hapësirë ku krejt parcelat janë komunale, domethënë ky 14 arshi gjendet në mes parcelave ku janë krejt të komunës, për shkak se e kemi identifikuar një hapsirë parcelave të mëdhaja që janë diku më shumë se tre hektar ku po ndërtohet QKMF-ja e re, po ndërtohet një çerdhe, është një pjesë e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, një pjesë ja kemi dhënë Ministrisë së Kulturës për ndërtimin e arkivës që nuk e ka shfrytëzuar aktualisht se ideja e tyre është me bë arkivën te internati. Megjithatë janë qeto parcela edhe një pjesë e objekteve ilegale që kanë qenë aty janë rrënuar, tash ajo hapësira është shumë e madhe. Kështu që ka hapësirë, por unë po besoj që të rrijmë te konteksti për të cilin është e propozuar se unë besoj që është njëra prej projekteve më të rëndësishme që realizohet pas lufte në këtë drejtori.

Adem Shabanaj: nëse mund të ndërlidhem te Nënkryetari se unë shikova numrin e parcelës edhe e pashë ku gjendet parcela. Parcela nuk gjendet në atë pjesën ku janë tuj u ndërtuar, numri i parcelës 11048...

Kujtim Gashi: është knej rrugës.

Adem Shabanaj: është kënj rrugës edhe nuk ka hapësirë për me u zgjeru më shumë se 14 ari sepse janë të tjerat këto parcelat janë private. Domethënë hapësira që mundet me u shfrytëzu është katër ari e 15 m², për më tepër nuk ka mundësi me u bë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Adem. Levent a pate me shtuar diçka?

Levent Bush: Pse Bashkim vetëm Qendra e autizimit?

Bashkim Rakaj (DPMS): Për me qartësu pak këtë situatën në zgjerimit. Unë po e kuptoj zgjerimin rritja e kapaciteteve në qoftë se po mendoni për të ardhmen.

Bajram Kastrati: Rritja e projektit.

Bashkim Rakaj (DPMS): Po nuk lejohet me standarte rritja e projekteve sepse shërbime duhet me marrë një kategori të caktuar për shembull autik më shumë se 40 për periudha nuk shkon më shumë por dhe s'ka nevojë. Për shembull ne duhet me bë një objekt tjetër, me një zonë tjetër por jo në atë vend me rrit me bë për shembull për 100 persona ose për 80 persona.

Kujtim Gashi: Edhe ta kemi parasysh, është me standarte, nuk lejohet se duhet me kallzu Bashkim që autizmi me kanë bashkë me një aftësi tjetër të kufizuar. Secila kategori ka specifikat e veta për këtë nuk mundet me kanë me një objekt.

Bashkim Rakaj (DPMS): Nuk mundet me kanë me një objekt.

Levent Bush: E ke për shembull në Maqedoni, hiç mos shko deri në Turqi e ke dy anët hyrje, i ke në hyrje të veçantë domethënë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Në qoftë se nuk keni dhe diçka tjetër atëherë po i hedhi në votim këto propozime. Propozimi i parë pra mbi dhënien e pronës komunale, kush është për që të hyjë në rend dite? gjashtë jemi për, faleminderit. Atëherë edhe vendimi për formimin e komisionit

vlerësues, se këto shkojnë bashkë. Nëntë jemi prezent, gjashtë jemi për, kundër a ka? po se edhe pikën e parë nuk e qita, kundër jo, një abstenim. Faleminderit shumë. Ju kisha kthyer edhe pikës së parë, meqë nuk e qita kundër, kundër a ka për pikën e parë, për dhënien e pronës? jo, adstenim një, domethënë të dyja pikat nga një abstenim. Atëherë po e hedhim në votim pikën e rendit të ditës bashkë me propozimet e reja. Kush është po? jemi shtatë për, kundër, zero, abstenim një. Ju faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vitin 2025.

Antigona Bytyqi: Po këtu e kemi zyrtarin Gjaferin. Gjafer fjala për juve.

Gjafer Ponik (DEF): Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Si çdo vjet domethënë bëhet bartja e të hyrave vetanake të cilat kanë tepruar prej vitit paraprak. Kështu që edhe këtë vit në 2025 mjetet të cilat kanë tepruar nga të hyrat në vitin 2024, domethënë janë vlerë prej 1,205.617.27 euro. Kështu që sipas shpërndarjeve dhe kërkesave që i kemi pas të drejtorive, është një tabelar që e kemi këtu për drejtoritë nëpër kategori ku ka pas nevojë domethënë më së shumti është në Drejtori të Arsimit në paga kanë kaluar 45.000.00€, pastaj malla shërbime janë 129.882.00 euro. 23.000.00 euro janë në shërbime komunale, në shëndetësi janë 249.000.00 euro, tek zyra e kyetarit janë 50.000.00 euro malla shërbime, kurse pjesa më e madhe prej 954.000.00 eurove është në investime kapitale.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Po urdhëro Karanfil.

Karanfil Haxhillari: E ku kanë tepu këto? Kah janë mbledhë këto?

Gjafer Ponik (DEF): Këto janë të hyrat vetanake të cilat kanë qenë planifikuar, domethënë për vitin 2024 janë tejkalu të hyrat më shumë se planifikimi.

Karanfil Haxhillari: Ku për shembull?

Gjafer Ponik (DEF): Të hyrat në përgjithësi, nga tatimi, nga marrja e lejeve me urbanizëm.

Kujtim Gashi: 300.000.00 euro e ca janë gjobat që policia që i shqipton nëse ke rënë në radar najher.

Gjafer Ponik (DEF): Ato domethënë nuk mundesh me i shfrytëzu se vijnë vitin vijues.

Antigona Bytyqi: A ka dikush tjetër?

Karanfil Haxhillari: Unë hala se kryjta. Mjetet prej hyrave vetanake të cilat vijnë më tepër se që është planifikuar, e që po besoj këto janë më së shumti nga lejet, sepse po e shohim gjithandej një kaos urbanistik që po bëhet, po jepen leje pa kritere, ndërtime pa kritere dhe këto të shkojnë në blerje të automjeteve, të veturave, unë s'po e shoh të arsyeshme! Këto janë pare të cilat kanë hy, janë pare të qytetarëve të cilët kanë hyrë në komunën e Prizrenit, por të shkojnë hala në rregullime të trotuareve, në shërbime të cilat nuk i keni planifikuar dhe shumica është në shërbime publike, domethënë kryesisht në projekte që këto u kanë dashtë shumica prej tyre veç me i kryer. Por që na

tashmë e dimë që borxhi deri tani në shumë kompani jeni futur deri në fyt dhe përmes këtyre po besoj, jo po besoj po kjo është 1 milion, është një çerek i atyre që i keni borxh. Por që arsyeshmëria e bartjeve të mjeteve vetanake në asfalt edhe në blerje të veturave, mua po më vjen me të vërtetë keq edhe unë nuk e mbështes një ndarje të tillë.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Karanfil. Dikush tjetër? A ka dikush diçka me shtu rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë pikën e dytë po e hedhim në votim. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme e cila do të mbahet nesër? Prezent jemi nëntë anëtarë, pesë jemi për, katër kundër, zero abstenim. Atëherë kjo pikë i rekomandohet mbledhjes së ardhshme. Ju faleminderit. Kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë;

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidentar i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane;

Antigona Bytyqi: Urdhëro Nënkryetar.

Kujtim Gashi: Faleminderit Kryesuese. Në fakt ju e dini e keni pas edhe në kuvend si diskutim edhe keni nxjerrë një rekomandim. Megjithatë e kemi bërë një analizë kështu të thukhtë në kabinet edhe kemi ardhë në përfundim, meqë është rast specifik e kemi pas edhe një viktimit edhe dëmet po ashtu të lokaleve aty përreth edhe të u bazu në rregulloren komunale për subvencione, kryetari ka nxjerrë një vendim i cili bazohet në këtë rregullore të rastet emergjente ku kryetari mund t'i mbulojë shumat deri në 3000.00€ edhe nga lista që e kemi pas edhe që e keni ju përpara, domethënë përjashtoj dy, të gjithë të tjerët mbulohen përmes kësaj rregullore sepse shumat janë nën 3000.00€. Kurse i kemi dy raste, një rast ka qenë 6000.00 e diçka euro, që e kemi propozu këtu me mbulu me gjysmën e tyre, domethënë diku 3000.00€ edhe rastin tjetër që e kemi sjellë në kuvend është me 30.000.00 euro për shkak se ne besojmë fuqishëm që kjo lëndë ka me u trajtu edhe në qeveri dhe një pjesë ndoshta besoj që kanë me mbulu edhe ata. Përkundër faktit që të gjitha planifikimet tona na pamundësojnë me realizu një mbështetje të tillë, megjithatë kemi larguar diçka prej projekteve që i kemi me marrëveshje, me qëllimin e vetëm që ta respektojmë edhe rekomandimin e Kuvendit, por në të njëjtën kohë edhe t'i dalim sadopak në ndihmë këtyre bizneseve dhe personave të cilët janë atakuar me këtë rastin e shpërthimit të fishekzjarrave. Kështu që ju e keni vetëm një propozim, vetëm për atë rastin që e ka lënë shumë, që nuk mund me mbuluar kryetari përmes rregullores e që duhet me marrë një vendim në kuvend për me i ndarë 30.000.00€ nga pozicioni i subvencionit te zyra e kryetarit të komunës.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkryetar. A dëshiron dikush me marrë fjalën rreth kësaj pike? Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani: Nënkryetari tha që ne e kemi respektuar vendimin e kuvendit. Rekomandimi i kuvendit ka qenë gjithë lista të cilët kanë qenë të dëmtuar, tash me i ekskluduar dy vete aty.

Kujtim Gashi: Listën e kemi kryer, listën e kemi marrë me veti.

Dafina Alishani: Jo s'është, lista ka qenë totale bashkë me këta dy qytetarë të cilët i kanë shumat e mëdhaja. Domethënë nëse ju e heqni prej listës pa u diskutuar në kuvend ose pa u diskutu në KPF, atëherë çka është nevoja në këtu me votu. Në votojmë dhe ju duhet ta realizon ose nëse nuk është e mundur me realizuar paraprakisht para se të bëhet vendimi ish dashur me u mbledhë

përfaqësuesit e grupeve parlamentare edhe me u diskutuar me gjet ni modalitet. Njerëzit që janë të dëmtuar më së shumti, tash po ulem edhe po bëjmë pazarllëk, po kqyrim qysh me ja bë 50% a me i pagu a mos me i pagu, kur ata janë më të dëmtuar. Edhe unë s'po e kuptoj si nuk respektohet rekomandimi i kuvendit, a nuk duhet qashtu qysh është votuar në kuvend qashtu me vazhdu vendimin pavarësisht çfarë modaliteti ka kryetari ose çfarë. Çka votohet në kuvend qajo duhet me u realizu.

Kujtim Gashi: Nuk e di kesh shumë i qartë, po duhet me e përsërit edhe njëherë! E para komplet lista është e mbuluar..

Dafina Alishani: Nuk është komplet.

Kujtim Gashi: Po është se pjesa tjetër...

Dafina Alishani: jo, dy banorë janë të ekskluduar.

Kujtim Gashi: Për këtë që po flasim tash.

Dafina Alishani: Po.

Kujtim Gashi: Komplet lista është e kryer me vendim të kryetarit, i kemi dy raste ku një rast ka qenë 6.615.00€ dhe ky rast mbulohet me 3.000.00€ me vendim të kryetarit.

Dafina Alishani: Pse?

Kujtim Gashi: Sepse deri aty e ka të drejtën kryetari. Edhe rastin tjetër ne e kemi propozuar 30.000.00€ për shkak se ato janë mundësitë tona buxhetore. Ju mudeni me nxjerrë vendim edhe 300.000.00€ po ai nuk ekzekutohet se nuk ka mjete.

Dafina Alishani: Ekzekutohet kur i keni mjetet.

Kujtim Gashi: Nuk kemi mjete në 2025.

Dafina Alishani: Në 26.

Kujtim Gashi: Në 2026, ai vendim është i pavlefshëm.

Dafina Alishani: Pse është i pavlefshëm.

Kujtim Gashi: Sepse nuk e ke planifikuar, domethënë mundësitë tona buxhetore janë membulu me 30.000.00€ edhe besoj që ky është një vendim i mirë. Nëse keni shumë vullnet duhet pak me lubu edhe nalt në qendër se ata e kanë obligim me kryer këtë punë, ne se ke kemi për me ditë, po ne kemi veç vullnet sepse obligim në rastet emergjente ne nuk kemi. E ka marrë përsipër qeveria me i mbulu rastet emergjente kur ndodhin në fatkeqësi, në bujqësi edhe në të gjitha. Megjithatë po e bëjmë një rast përjashtim për shkak të natyrës që ka ndodhur edhe për shkak të vullnetit politik që e kemi pas edhe na edhe ju edhe krejt.

Dafina Alishani: Vullnetin politik se keni pasë?

Kujtim Gashi: Mos kyrni me e degradu, se s'po du me hy në këtë temë, se mundet me u fshfrytëzu politikisht

Dafina Alishani: Jo jo, s'është degradim.

Kujtim Gashi: Qeky është propozimi, nëse keni vullnet me mbështet mirë, nëse s'keni vullnet...

Dafina Alishani: Ta kishit pas vullnetin edhe ti edhe kryetari kishit qenë aty kur është diskutu.

Kujtim Gashi: Aty kam qenë mos ta nin, kam qenë në rast kur ka ndodhë.

Dafina Alishani: Jo s'keni qenë.

Kujtim Gashi: E di unë ma mirë.

Dafina Alishani: Po e di unë se sa panori na ka ardhur në der neve edhe te ju sa kanë ardhë.

Kujtim Gashi: Sa më kanë ardhur mua ty s'të kanë ardhur. I njoh edhe familjarisht edhe miqsisht edhe rkejt, mos më shtin se krejt, mos hyn sepse në këto tema jeni kanë të humbur.

Dafina Alishani: Pse të humbur?

Kujtim Gashi: Sepse ke dashtë me e shfrytëzu politikisht.

Dafina Alishani: Ka humbur jetë një njeri aty për shkak të mos punës të inspektoriatit të juaj.

Kujtim Gashi: Jo inspektoriatit, por doganës së juaj që i ka lënë me hy ato, su dashtë me i lënë me hy në doganë.

Dafina Alishani: Ti je vonu si qeverisje.

Kujtim Gashi: A po don me hy në tema bash pastër, në doganë nuk u dashtë me i lanë me hy. Dogana u dashtë me i nalë ato, s'un i ndalë inspektoriatit. Doganën kush e udhëheq? Pse si ka ndalë dogana?

Dafina Alishani: Mirë bre, qe qeveria e keqe, ju pse si keni ndalë, pse i keni leju me shit.

Kujtim Gashi: Aty janë shitur ilegalisht.

Dafina Alishani: Po a, pse i keni leju ani?

Kujtim Gashi: Pse i keni leju me hy, ja keni pagu doganën. Mos më shtin këto tema.

Antigona Bytyqi: Ju lutemi të qëndrojmë te pika. Po Karanfili e ka fjalën.

Karanfil Haxhillari: Nën një kemi të bëjmë me një rast shumë të ndijshëm ku kemi një jetë të humbur dhe dhjetra lokale dhe dëme prej fishekzjarreve. Neve në kuvend e kemi e kemi votuar një vendim...

Kujtim Gashi: Rekomandim.

Karanfil Haxhillari: Rekomandim ku përfshihen dhe sot unë para e shoh vetëm një vendim që Enis Dana me u kompenzu me 30.000.00€. Domethënë në bazë të këtij vendimi e shoh që vetëm me Enis Danës duhet ti jepen 30.000.00€ dhe këtë ne duhet me e votu që këto 30.000.00 euro. E për të tjerët, në qoftë se në këtë moment nuk e kemi në vendim dhe të tjerët...

Kujtim Gashi: është vendimi i kryetarit.

Karanfil Haxhillari: ato atëherë ne jemi, ne po e bëjmë në këtë rast duke u nisur për një barabarësi për të gjithë dhe për të mirën e të gjithëve ne po bëjmë, po e tejkalojmë këtë dhe po kalojmë vetëm për të mirën e një individi.

Kujtim Gashi: Jo s'është qashtu.

Karanfil Haxhillari: A mundemi me e ditë dëmi i qetij Enis Danës sa është?

Kujtim Gashi: 66.000.00 euro.

Karanfil Haxhillari: E vetëm 30.000.00 me ju dhënë këtij apo?

Kujtim Gashi: Po.

Dafina Alishani: Paskan vullnet.

Kujtim Gashi: Vullnet edhe aq mundësi.

Karanfil Haxhillari: E të tjerët?

Kujtim Gashi: Të tjerët janë komplet të kompenzum se shumat janë të vogla, 100, 300, 400, 500, 700. Të tjerët domethënë janë të mbulum komplet.

Karanfil Haxhillari: A është biseduar me këtë personin, a është pajtuar që në këtë rast vetëm gjys ka me ju kompenzu? Jo, ai fillimisht është pajtuar që s'po mbështetet hiç se këtë mesazh e ka marrë, tani e kemi thirr edhe njëherë dhe i kemi treguar që ne pjesërisht po të mbështesim, pjesën tjetër urojmë që të mështet qeveria kushdo qoftë ajo që vjen sepse e ka obligim.

Dafina Alishani: Edhe u pajtun ata a?

Kujtim Gashi: A u pajtuan a jo atë nuk e di. Tash unë sun ia marr atij pëlqimin me vet çka, veç e kemi njoftuar.

Karanfil Haxhillari: Ne e qesim edhe në kuvend dhe diskutojmë ma gjërësisht edhe në kuvend a din. Meqënëse është çështje e ndjeshme, po edhe një pyetje kam. Aty në kuvend është fol edhe për familjen e te ndjerit në këtë rast.

Kujtim Gashi: Nuk kemi vendim për atë, se s'kemi qysh me mbështet, ne jemi tuj i mbështet biznesat që janë dëmtuar objektet e tyre, nuk jemi tu i financu njerëz që kanë vdekur. Domethënë duhet me i nda këto tjera, po flasim për objekte, për dëme, për tesha që ju kanë ndjek këtij zotënisë

komplet. me mbështet, ata që kanë pasur vullnet me mbështet sëmundjen e tij kanë mbështet në forma tjera.

Antigona Bytyqi: Po urdhëro Florent.

Florent Ukaj: Ne si LDK nuk do të bëjmë politikë me këtë temë dhe do ta mbështesim. Por një kërkesa e jona është që jo vetëm për këtë rast por për raste të tjera të ketë vullnet nënkryetar politik që jo të bëhet selektimi, pa mas parasysh se çka ndodh në një rast. Dihet që edhe pak a shumë është edhe faji i i komunës të inspektoriatit që të janë leju nëpër çdo vend me u shitë ose me u ekspozuar kur dihet çfarë rrezikshmërie derisa ndodhi ky rast. Andaj ne do ta mbështesim në këtë pikë, por kërkojmë nga ju që ka dhe shumë raste të tjera, ka shtëpi të djegura, ka dëme në bujqësi dhe nuk keni pasur vullnet. Domethënë këtu po e dëshmoni pas të drejtë kemi pas, se neve sa herë, unë personalisht kam bërë pyetje në kuvend, sa herë neve na u ka thënë si të them na u ka ly kryet me akull që nuk kemi të drejtë, por qeveria ka të drejt, kemi hudh akuza dhe unë personalisht te qeveria, por po del që nuk qenka bash ashtu qysh qysh na keni shpjegu në kuvend. Prandaj vullneti politik duhet me ditë publikisht që nuk ka qenë për raste të tjera, për këtë rast ton natyrisht që ne do ta mbështesim, jo veç këtë rast, shpresojmë mos të ketë raste të tjera të fatkeqësive në komunën tonë dhe në çdo kund në Kosovë, por me asnjë rast ne nuk do të bëjmë politikë, do ta mbështesin, por jo të trajtohet ndryshe rasti prej rastit. Faleminderit.

Kujtim Gashi: Florent, nëse bën shkurtimisht. Vullneti dhe mundësia dallojnë, domethënë dëmet që u shkaktuan në bujqësi janë shifra shumë të mëdhaja, e kolapsojnë komunën.

Florent Ukaj: Jemi përgjysmu që s'ju keni përgjigj rasteve tjera.

Kujtim Gashi: është totalisht e pamundur se me një vërshim ndodhin deri në gjysmë milioni e një milion dëme. Ne po flasim për një rast më specifik që u kanë, e ishalla s'ka kesi raste se me pas raste normal që do të ketë prapë vendime, po urojmë që të jetë i fundit. Kurse dëmet në bujqësi, dëmet nga raste të tjera emergjente i ka obligim Qeveria e Republikës së Kosovës kushdo që është ai, për shkak se për ta ka legjislacion. Tjetër send është vullneti politik, tjetër send është mundësia edhe tjetër send është obligimi, domethënë këto duhet ti dallojmë. Përndryshe edhe në ato raste vullnet ka pasur, veç më kallxo ku i merr lekët.

Florent Ukaj: Nuk është veç bujqësia, është edhe një shtëpi në Prizren ku u kanë vlera diku 40 mijë euro që u djegë, as nuk e njoh kush është edhe nuk është marrë asnjë vendim. Duhet me pranë edhe ju publikisht, shkak që u bë medial ky rast po i ndërmerrni këto veprime.

Kujtim Gashi: Nuk është e vërtetë kjo që po e thu. Problemi është që unë për me thënë dikuj duhet me ja dhënë dikujt 1000€, unë veç të pyes pyetjen e parë që ja bëjë drejtorit është ku i merrë? domethënë veç me kallëzo ku i merr dhe në rregull jemi.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Egzona a deshte diçka me u ndërlidh?

Egzona Hoxhaj: Jo se u konsumu mjaftueshëm.

Antigona Bytyqi: Dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë po hedhi në votim pikën e tretë që t'i propozohet mbledhjes, që t'i rekomandohet mbledhjes. Kush është për? prezent jemi nëntë anëtarë. Nëntë jemi për, kundër s'ka, abstinim s'ka. Unanimisht të gjithë, faleminderit të gjithëve. Kalojmë te pika e katërt.

Pika e katërt:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës së Prizrenit për emërtimin e rrugëve në territorin e komunës së Prizrenit të datës 15 dhjetor 2016, zonave të qarkullimit publik në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi: Kryetari i komisionit ta merrni fjalën.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese. Sa i përket kësaj temës, realisht na përgjegjës për ekzekutimin e ose prurjen në kuvend të kësaj pike nuk jemi, është Drejtoria e Urbanizmit. Megjithatë ne jemi organizuar si kuvend me i ndihmu në këtë proces dhe e kemi bërë punën tonë. Në bazë të takimeve që kemi pasur në vazhdimësi, kemi pasur përfaqësues të të gjitha subjekteve, po dua me e cekë, tash përfaqësuesi i subjektit Vetëvendosje ka qenë vetëm me një takim, megjithatë e ka pasur informatën edhe secilin vendim që e kemi marrë e kemi marrë në vazhdimësi si komision. Fillimisht kemi marrë vendim që së paku nga secili subjekt përmes përfaqësuesve të tyre që i ka t'i sjell nga pesë emra për plotësimin e listës së rezervë. ligjërisht na është leju plotësimi i listës rezervë edhe tash në krahasim me emrat që i kemi aktual edhe rrugë që duhet me u emërtu ka nevojë do të thotë për plotësimin e listës së rezervës. Sa i përket emrave, secili nga anëtarët e komisionit i kanë sjellë emrat në bazë të propozimeve të tyre, në kohën e fundit kemi pasur pakënaqësi edhe në mesin e komisionit se janë ndalë, kanë diskutuar në emra konkret. Personalisht mua, përderisa kemi marrë vendim si komision nuk më ka bërë përshtypje emri, përderisa na i kemi dhënë mundësi secilit subjekt me pru. Kështu që ka pas kohë edhe me një takim tjetër të KPF-së e pata propozu unë, që i bjen data, mundësia me gjet në cilën datë, e keni shty, keni thënë jo, do të thotë jeni ndalë në emra konkret edhe e keni shty. Tash me vendim të komisionit edhe në koordinim të plotë me Drejtorinë e Urbanizmit e kemi sjellë propozim- vendimin për plotësimin e listës së rezervës. Për momentin i kemi diku 92 emra kryesisht prej anëtarëve të komisionit, por kemi pas edhe kërkesa që janë drejtuar nga këshillat lokale, qytetarët përmes Drejtorisë së Urbanizmit. Drejtoria e Urbanizmit në vend që me trajtu vetë këtë çështje përderisa është kompetencë e tyre, na kanë drejtuar neve kërkesat. Kështu që ne si komision i kemi trajtuar edhe jemi munduar e kemi dhënë maksimumin. për me qenë sa më konstruktiv edhe me trajtuar secilin propozim ose kërkesë që na ka ardhur. Tash në bazë të asaj ne s'kemi pas kohë me u marrë me biografinë e secilit veç e veç, përderisa kemi pas kërkesa dhe deri në ditët e fundit. Ne kemi një listë që kemi emra me biografi, po kemi edhe emra që ende s'i kanë sjellë biografitë. Në komision kemi marrë vendim që Egëzona me i marrë edhe me i skanu krejt biografitë çka na kanë ardhur edhe me ju sjellë. Por përderisa na kanë ardhur kërkesat do të thotë deri sot kemi pas.

Egzona Hoxhaj: Me vendimet e KPF-së sot Arbëri e përcjell edhe listën.

Bajram Kastrati: Ne mudemi nesër me i pasë krejt emrat, mundeni me pas edhe tash emrat edhe me i lexu emrat, po ka edhe anëtarë të komisionit që kanë dhënë kontribut shumë edhe janë kundër emrave. Tash me u ndal edhe në komision po edhe në kuvend sigurisht në momentin kur një propozim i imi kundërshtohet prej tjetrit, tani automatikisht edhe unë mund me ja kundërshtu propozimin e tij. Megjithatë jemi munduar që emrat me i pranë njerëz që kanë dhënë kontribut për qytetin.

Kujtim Gashi: A bënë një pyetje më fal? Nëse vjen sot një propozim, çka ndodhë?

Bajram Kastrati: Propozimet ma i kemi ndaluar.

Karanfil Haxhillari: I keni ndaluar? Ne që jemi në këtë rast si vetëvendosje që ok, krye pastaj unë.

Bajram Kastrati: Jo, po ju jap përgjigje të dyve menjëherë. Po e kuptova, është pyetje se s'ke duke më dëgjuar, në fillim e thashë Nënkrjetar. Thash në bazë të kërkesave të rrugëve të reja, neve po na del që duhet me plotësu listën e rezervës, edhe me 100 emra ne mundemi me plotësu listën e rezervës, përderisa rrugë të reja kemi vazhdimisht edhe e di që do të thotë gati krejt kanë me na shku nëpër rrugë edhe pse kemi edhe. Përderisa edhe lista paraprake ka gabime të shumta, komisioni paraprak kanë bërë gabim, gabime të shumta përderisa ka rrugë të emërtuara, ai emër është edhe në listën e rezervë, dhe duhet me u filtru. Po tash ne si komision po e kemi problem me u marr me krejt përderisa s'po e kemi edhe kompetencën por s'po e kemi edhe këtë programin që e kanë Drejtoria e Urbanizmit. Te drejtoria e urbanizmit asnjë vullnet më i vogël s'është për me punu në këtë drejtim duke i përfshi, tuj fillu prej drejtorit me zor i kemi marrë ata çka na u kanë dashur. Përveç dy zyrtarë tash i ka angazhuar Agjensioni Kadastral, ata e kanë dhënë kontributin e tyre. Sa i përket juve Fil që s'ki marrë informata. Unë edhe në takimin e kaluar i thashë Islamit që ke mungu vazhdimisht, i kam lutur edhe në grup i kam lutur e i kam thirrë, që dy javë e kena thirrë në telefon edhe në drekë i kam thirrë për me dhënë kontribut secili ka pas mungesa ka mungu edhe Levent Bush, ka mungu edhe Islami.

Karanfil Haxhillari: Unë kam qenë pjesë e këtij komisioni, po jo komisioni për emërtime, por komisioni për rishqyrtime dhe ankesa nga qytetarët për emrat e vendosur në vitet 2014/2015. Aty si komision i kemi bërë mbi 200 takime edhe në kohë pandemie dhe është bërë një ndryshim sepse në vitin 2014/2015 kur janë bërë emërtimet e rrugëve kanë bërë emërtime fatale gabim, dhe a e din çka jam duke u frikësu që edhe tash i njëjti send po ndodh. Nuk mundet Bajram subjekti politik me propozu emër të rrugës, nuk ka logjikë një subjekt politik me propozu emër të rrugës, emrin e rrugës e propozojnë qata njerëz, ajo bashkësi ku jeton dhe ku ka me kaluar ajo rrugë, gjithmonë duke e arsyetu se pse duhet të jetë ai emër, pra të ketë biografi. Por jo na si anëtarë të KPF-së apo si subjekt politik, apo. Është e gabueshme sepse nuk mundemi ne t'ia imponojmë një emër që ka ndodhur ku nëpër një lagje të caktuar shkon emri i gjakësorit nga viktima, dhe në këtë rast prapë jemi duke e bërë gabimin e njëjtë. Neve e dimë që Agjensioni Kosovar i Kadastrit ja ka ndaluar jo vetëm Prizrenit por të gjitha komunave për 10 vite të ardhshme ndryshimin e çdo emrit, po për shkak të stabilitetit

Bajram Kastrati: Ndryshimin po por jo emërtimin.

Karanfil Haxhillari: Edhe tash neve çka kemi me bë, ne më përpara kemi shumë probleme nëpër rrugë në komunën e Prizrenit, shumë qytetarë nuk janë duke na pranuar rrugët që i ka vendosur, që janë vendos më herët, kemi po më vjen keq po unë e di se jam kanë pjesë e atyre tubimeve, me të vërtetë kemi bastardim të emërtimeve të rrugës nëpër shumë shumë lagje. A është marrë, a jeni tuke punuar tash në këtë pyetje e parë si komision. dryshimet që janë bërë në vitin 2017/2021 që është punuar nga një komision ku kemi tentuar që së paku t'i përmirësojmë emrat ku janë kanë gabim, me i qit nga emrat rezervë dhe me i përmirësu dhe sot kur ta kqyrim nuk na kaluar asnjë. Domethënë prapë gjenden ata emrat fillestarë të 2014-ës, 2015-ës.

Egzona Hoxhaj: Tash në maj të 2025-ës ju përfundon, aj vendim edhe kur të përfundon aj vendimi i 2015-ës 10 vjet afati, ata ndryshohen, hyjnë në proces për me u ndryshuar. Së paku këtë përgjigje e kemi prej agjencionit.

Karanfil Haxhillari: është Udhëzim Administrativ i vitit 2019, si Udhëzim Administrativ që e ndalon 10 vitet e ardhshme ndryshimin e emrave.

Bajram Kastrati: Veç një moment Fil, shumë lehtë është ne me akuzu edhe komisionin sidomos na edhe komisionin para juve dhe juve pse se mund me fol çka të dojmë edhe ka arsye, ka fakte që është banalizuar emërtimi i rrugëve. Por ne kemi dhënë maksimum atë çka na lejohet ligjërisht, ndryshimi i emërtimeve nuk lejohet dhe na ka ardhur me shkrim prej ministrisë nuk lejohet dhe s'jemi marrë me ndryshimin edhe secili qytetar që ka pas kërkesë i kemi dhënë përgjigje që s'kemi të drejtë ndryshimi deri në 2029-tën. Cili është faji juaj që jeni marrë ju me qet punë? Është që ju qat rast që e keni trajtuar nuk i keni shkuar deri në fund me marrë një përgjigje edhe me u rregullu ajo çështje. A keni punuar me një rast me një rrugë të caktuar për një ndryshim të caktum.

Karanfil Haxhillari: Krejt rrugët, krejt me të gjitha ndryshimet që..

Bajram Kastrati: Edhe çka është marrë, a i keni shkuar deri në fund asaj pune?

Karanfil Haxhillari: O po burrë, por na ka kthyer të paligjshme Ministria e Pushtetit Lokal.

Bajram Kastrati: E tash përderisa e ka kthyer të paligjshme është bllokuar procesi aty. Unë mu për këtë kam propozu që me hy në plan të punës të kuvendit me pa ku jemi, unë po bi tash, ne e kemi një mundësi, tash e kemi pru, na një mundësi e kemi për plotësimin e listës së rezervë për emërtimin së paku të rrugëve të reja. Edhe tjetra na ka lejuar edhe ministria tash emërtimin jo në bazë të alfabetit, qysh e kemi pas të ndalume, tash e kemi në bazë të përzgjedhjeve dhe të kërkesave të komunitetit. Sa i përket që the, partia politike me propozu. Këta janë përfaqësuesit e qytetarëve deri në përzgjedhjen e këshillave lokale, në momentin kur janë përzgjedh këshillat lokale ne kemi kontaktuar direkt me këshillat lokale, i kemi trajtuar kërkesat prej këshillave lokale dhe prej përfaqësuesve poshtë, por nuk guxon me u emërtuar. Tash procesi i emërtimit është një tjetër, ky është proces veç plotësimi në listën në rezervë, po nuk guxon me u emërtu. Kemi marrë vendim si komision e kemi dhënë ide, s'guxon me u emërtu asnjë rrugë përveç në bazë të kërkesës të komunitetit të caktuar atje. Nëse e ka emrin te lista e rezervë ose ka me përzgjedh te lista e rezervë nëse s'ka emër ka me përzgjedh ai komunitet të cilin emer e don për emërtimin e asaj rruge. Përndryshe duhet me prit deri në 2029-tën që s'ke me mundur me bërë asnjë ndryshim.

Karanfil Haxhillari: Veç edhe një nënpyetje. Çka ndodhi me listën rezervë të kaluar sepse kur janë emërtuar komplet rrugët.

Bajram Kastrati: është lista e rezervë Fil, se unë e thashë në fillim ka listë rezervë emra në rrugë ka edhe emrat e lista rezervë, është duke u filtruar ajo lista rezervë edhe në momentin ne e kemi paraparë që duhet me u plotësu lista rezervë edhe dotëthotë mu pastru edhe me ditë ku i kemi emrat e listës rezervë e jo me pas emër edhe në listë rezervë edhe të vendosur në rrugë.

Egzona Hoxhaj: Ka pasur emra në listë rezervë dhe ju kanë vendosur shesheve a po kupton?

Bajram Kastrati: E nevojshme është që ne mujm me qu me 100 emra lirisht plotësimin e listës rezervë emra që propozohen. Kryesisht tash janë propozu prej subjekteve sepse qeta janë përfaqësues të qytetarëve prej kah janë ardhë aty, kur janë përzgjedh këshillat lokal jemi marrë me këshillat lokal.

Kujtim Gashi: A bënë një pyetje shtesë me ta bë? Këto po shkojnë në kuvend, kryhet seanca. A kanë të drejtë këta këshilla dhe qytetarët pas 3 dite me bë një propozim? Kjo po më intereson.

Bajram Kastrati: Jo, ky është propozim-vendim që shkon në ministri.

Kujtim Gashi: Domethënë përfundon me...

Bajram Kastrati: Përfundon me lista rezervë.

Kujtim Gashi: Edhe nuk ka ma?

Egzona Hoxhaj: Jo nuk ka tani.

Adem Shabanaj: Mirë është me shty edhe me bo plotësimin.

Bajram Kastrati: Me ba plotësimin por prej kujt me bë plotësimin tash se mund me na ardhë edhe 100 emra.

Antigona Bytyqi: Flisni me radhë ju lutem se për shkak edhe të procesverballi tani po duhet.

Kujtim Gashi: Po le të vijmë edhe tjerë, sa duhet me kanë?

Bajram Kastrati: po prej kujt duhet me ardhë ne i kemi bë kërkesë, ne i kemi shtjerrë krejt mundësitë. Kemi bë kërkesë prej Vetëvendosjes, tash për shembull përfaqësuesve të Vetëvendosjes na ka ardhur veç një emër edhe na ka dhënë një kuvendare emrin e Asrit Deharit, e kemi pranë, e kemi futur në mesin e këtyre të propozuarve. I kemi lutur këshillat lokale, tashi edhe nëse e shtyjme çka me bë Nënkrjetar? a me shku nëpër fshatra me ju thënë a keni emra të tjera.

Karanfil Haxhillari: A bënë edhe një pyetje? Cilat këshilla lokale Bajram?

Bajram Kastrati: Qeta të përzgjedhnit që janë.

Karanfil Haxhillari: Komplet i keni i keni pyet?

Bajram Kastrati: I kemi pyet krejt çka kemi mund me i pyet. E kanë pas informatën e saktë Fil.

Kujtim Gashi: Ata janë këshillat në rregull, po unë e kam dilemën që ata s'janë të përfshirë jo pse ju se keni bërë punën e juaj por ata. Për shembull mua ka raste më kanë ndalë e kam parë rrugë që s'kanë emër!

Bajram Kastrati: Proces tjetër është ai.

Egzona Hoxhaj: Po de, po tash emërtimi i rrugëve është krejt diçka tjetër, se jena duke e keqkuptu që kjo është me shti emra për shkak që lista rezervë është e mangët, nuk ka emra të mjaftueshëm që duhen për me u emërtuar rrugët e reja.

Bajram Kastrati: Edhe me ju dhënë mundësi dikujt në Atmaxhë për shembull me ju dhënë mundësi me pas një emër që e don përderisa se kemi tash të ndaluar me ligj me shkuar në bazë të

alfabetit, po në bazë të kërkesës. Tash në Atmaxhë i jipet mundësia një emër me propozu edhe ajo rrugë që është e re mundet me atë emër në bazë të kërkesës që e kanë komuniti.

Kujtim Gashi: Po veç tash prap po kthehena, më fal se pak u bë por është temë me rëndësi. Po kthehena tek Karafili shumë është me rëndësi për shembull nëpër do lokalitete ose në fshatra nuk mundesh me ngjit çfarëdo emër me një lagje sepse ka rretha a po kupton? ka rrethana për lagjen ose është një i pari i tyre aty që e ka nis atë lagje ose është një njeri që ka dhënë kontribut në art, shkencë, kulturë, dëshmorë etj. Për qeta e kam pak si p.sh. me ja qu tash emrin Bajram Kastrati në Leskovec.

Bajram Kastrati: Nënkryetar, jam tuj të kuptuar ty po s'di a po më kuptoni mua.

Levent Bush: Njejtë është edhe për qytet.

Bajram Kastrati: Unë po them, tash ne e patëm mundësinë me i propozu emrat para se me filluar procesi i emërtimit të rrugëve të reja, qata emrat të propozuar ata mund me i qu se nuk e kemi të ndaluar edhe me ja qu emrin në bazë të alfabetit, po tash e kemi të lejuar, nëse bëhet një kërkesë në Arbanë e komunitetit, ne mund me përzgjedh tash emrin, rrugë e re është fjala e jo me bë ndryshimin.

Kujtim Gashi: Prej rezervës?

Bajram Kastrati: Po prej rezervës.

Kujtim Gashi: Ndoshta s'është qajo që po menojmë na.

Bajram Kastrati: E tash nëse s'është qaj emër, na mujmë komunitetit me ju thënë në bazë të këtyre emrave a keni, a e pranoni një? Nëse nuk pranojnë atëherë drejtorja e dinë çka bajnë.

Egzona Hoxhaj: A e din qysh, këto kanë me kanë probleme të vazhdueshme sepse p.sh. ti ke pasur prej një lagjes emër kryefamiljarin e vetë!

Kujtim Gashi: S;ka dert, kanë vendosur lagjja edhe në rregull është. te na p.sh. lagjet, rrrugët janë sipas të parëve qysh janë njoftë historikisht 120 vjet, domethënë lagja ajo, lagja kjo, rrugë kryesore janë me qeto emra. Domethënë me qu ti emër tjetër, unë s'po flas për aty por flas për fshatra të tjerë është problem.

Egzona Hoxhaj: Ama edhe udhëzimi i ri administrativ nuk po i lejojke ma për shembull me u quajt po e marr shembull lagjja Hoxhaj.

Dafina Alishani: Qysh po ja lejon partisë politike me propozu emra?

Egzona Hoxhaj: Nuk e di pse po kapeshe te partia politike, se s'ka propozu asnjë parti politike. Dafinë se ti mundesh me u kap ku duash a po e din këtë asi, por s'ka propozu partia politike. Në komisionin për emërtimin e rrugëve jena secili prej secilës parti politike ka një përfaqësues po edhe propozimet nuk janë të partive politike por janë të këtyre asambleistave që jemi të zgjedhur. Secili prej neve kemi kontaktuar me komunitetet tona prej kahit vijmë. Tash nuk është faji im as i Bajramit as i tjetrit që kolega i juve s'ju ka njoftuar juve edhe ju s'keni pas informatë për me u taku me komunitetin e juve.

Dafina Alishani: Edhe se pse pse po flisni veç për fshatra po edhe në qytet e njëjta është bre edhe në qytet irritohen njerëzit.

Antigona Bytyqi: Kanë pru edhe qytet.

Egzona Hoxhaj: Kanë pru edhe qytetet emra nonstop të qyteteve.

Dafina Alishani: Po emrat këtu që janë edhe qysh po pritni na me votu kur s'kemi listë.

Bajram Kastrati: Këtu e ke me vend. Unë me fillim e thashë po edhe tjetrat, tash nëse ekziston mundësia, na mujmë, kemi hapësirë me dhënë propozime edhe nesër në seancë që duam me shty ne më shpejtë si proces. Përndryshe unë e di si tash me emra qysh ndodhi herën e kaluar, qysh po ndodh edhe në komision te na propozohet një emër prej Bajram Kastratit për shembull dhe kundërshtohet prej Shukri Qunit ose anastjelltas. Tash ne kemi pas telashe edhe me emra, për këtë punë mirë është përfaqësimi i krejt subjekteve ka qenë komision, je përfaqësuese e popullit mos thuj që s'guxoj me propozu unë, se hpesht thu ne jemi përfaqësues të popullit edhe ke qejf a din me marrë, jo që ke qejf ti po është normale me marrë atë primatin e përfaqësimit.

Dafina Alishani: E përfaqësoj popullin,

Bajram Kastrati: Mirë, megjithatë unë e thashë...

Dafina Alishani: Edhe jam krenare që e përfaqësoj...

Bajram Kastrati: po mirë de edhe unë gjithashtu. Unë e thashë, deri sa si kemi pasur këshillat lokale ne jemi marrë me propozime të subjekteve politike, në momentin kur janë përzgjedh këshillat lokale jemi marrë me këshilla lokale. Nëse e vlerësoni ju që duhet me shty ne edhe prapë me kërkem emra e shtyjme nuk është ndonjë diçka që. Krejt ideja është krejt qysh me bë, me realizu se ka nevojë, ka nevojë edhe qyteti, edhe s'është kompetencë e jona hiç, është kompetencë ekzekutive e urbanizmit.

Adem Shabanaj: Më fal Bajram, emrat a duhet me i sjellë me biografi?

Bajram Kastrati: Me biografi, ne kemi marrë vendim me biografi. Tash për sa i përket komisionit, ne kemi bërë punë boll, edhe prapë mund me bë punë, edhe prapë mundemi me pranë emra. Për neve nuk është e rëndësishme a kalon tash a s'kalon, e rëndësishme është në përgjithësi për të gjithë, se ka nevojë me u emërtu rruga e re. Kam rrugë unë, nja tre-katër rrugë në Arbanë i kam që s'ka emër edhe tash qajo Arbanë ka mundësi për shembull ai komunitet ka mundësi me propozuar emrin edhe me pasur një emër edhe që janë të kënaqur. Jo si herën e kaluar, edhe banalizimi që është bë prej komisionit para këtyre, ai komisioni që i ka emërtuar, kanë propozuar emra të ndryshëm, emra familjarë.

Adem Shabanaj: Mundet me kanë edhe familjar, por kur e ka një biografi që mundet me pas një familjar.

Bajram Kastrati: Po po, ama ama veç pse u kanë prind i tina ka propozuar dhe ka pasur mundësi.

Adem Shabanaj: Po kur e ka një biografi?

Bajram Kastrati: Gjë që tash këto propozime tash s'kemi prej komisionit, kryesisht s'kemi, ka disa emra që janë të propozuar edhe familjarë që i kanë po s'kemi kryesisht se kemi.

Antigona Bytyqi: Po urdhëro Florent.

Florent Ukaj: Unë propozoj të tërhiqet, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme edhe normalisht të na sjellen edhe emrat kush janë ata emrat që i kemi.

Bajram Kastrati: Po veç mirë ish kanë nëse marrim vendim për me shty, është mirë më konkret me kanë me i marrë emrat edhe qysh doni me u angazhu ju me i siguru qato emrat që me u pajtu ne për ata emra.

Florent Ukaj: Bajram qata emra që i keni.

Bajram Kastrati: po keta i kemi,

Florent Ukaj: Ama na si kemi.

Bajram Kastrati: A ka nevojë me i taku krejt këshillat lokal me një takim apo qysh po mendoni ju? Nëse e shtyjme na, unë thash mundemi me shty se nuk është naj.

Florent Ukaj; o Bajram, na tash mujna me votu edhe me të kallxu të drejtën asnjë emër nuk e di që e keni qaty.

Bajram Kastrati: Po për qet punë edhe pse Marini tha jam kanë shumë mirë me juve, tha ju kam shkruar vazhdimisht.

Florent Ukaj: A keni emra na ka thënë.

Bajram Kastrati: Po a keni emra, edhe ka mujt qeta emra me ju përcjellë. Është faji jo krejt i joni që jemi vonuar me emra, se i kemi lypur biografite në vazhdimësi. Tash nëse doni me shty për seancën e ardhshme mundemi me shty. Nëse keni propozime, veç a di mos të vijmë tani prapë edhe njëherë edhe me thënë jo. Edhe diçka, mundësisht përmes përfaqësuesve që i keni në komision edhe juve, mos të ndalëm me u marrë se mundemi me dështuar nëse merremi ne pse është ky emër që e ka propozu Egzona ose pse është ky emër që e ka propozuar Bajrami.

Florent Ukaj: Bajram, unë tash nëse e shoh që në rrugën time po e zëmë, po e nisi prej vehtes gjë që kam hasur kesi probleme. Nëse e shoh që në rrugën time më ka vendosur emri i Bajram Kastratit.

Bajram Kastrati: ajo është punë e kryme.

Florent Ukaj: Po mirë de, po qatë jemi tuj e diskutu ne, as se dimë cilën rrugë, as se dimë cilat emna janë, asnjë informatë se kemi!

Bajram Kastrati: Lenti, tash në bazë të këtyre propozimeve, kur hyjmë në proces të emërtimit të rrugëve të reja jo rrugëve që janë të emërtuar, ato s'guxojmë i prek deri në 2029.

Floretn Ukaj: E kam të qartë atë.

Bajram Kastrati: Nëse e ke një rrugë të re, në bazë të kërkesës, nëse s'e ke ba ti propozimin në bazë të listës së rezervës ti ke me përzgjedh si komunitet cilin emër don me çu aty.

Florent Ukaj: Po nëse nuk ka një emër që...

Bajram Kastrati: E përderisa nëse nuk është atëherë propozojë emrin.

Kujtim Gashi: Unë në parim nuk vendosi, a e shtyni a se shtyni është puna e juaja. Veç nëse e shtyni duhet me mbajtë të paktën dy takime me këshillat. Unë jam tuj i mbajtë këto dëgjimet buxhetore, tash po e shoh sa vështirësi është me i mbledhë ata, njëherë po duhet me i thirr me i njoftu, tani po duhet me i thirr me i marrë propozimet. Kështu që si komisioni i juaji e para me i thirr me një takim me i njoftu edhe e dyta me i thirr në takim ata me i pru propozimet, se ky proces është i rëndësishëm, s'duhet me lënë. Unë e di që keni bërë punë të madhe, por kjo punë është te baza.

Egzona Hoxhaj: A bënë veç edhe një propozim? A mujna për me u bë sa më shumë publike se për shembull seancat e kuvendit po janë gjithmonë live edhe shumica e njerëzve po i shohin më shumë. A mujna për shembull me qu, me diskutu, me konsumu si pikë të rendit të ditës në seancë, aty ndoshta njerëzit e marrin informacionin më shumë tani edhe kontaktet me neve kanë me qenë më të kollajshme, se ndoshta është edhe mungesë e informacionit.

Karanfil Haxhillari: Ama jo kryetari i bashkësisë lokale prap me marrë vendim, duhet ju si komision me e obligu kryetarin e bashkësisë lokale që të takohet me komunitetin që bashkarisht ata të marrin vendim.

Bajram Kastrati: Propozimi i Nënkryetarit ke për atë arsye.

Kujtim Gashi: Nëse isha i qartë, këta kur e mbajnë takimin e parë duhet me i obligu ata me i mbledh këshillat, se te na është keqkuptuar kryetari mendon që është gjithçka. Aty është një këshill besoj që na pavarësisht çka Udhëzimi Administrativ, krejt pajtona që aty janë në këshilla krejt subjektet politike në shumicën e rasteve, për ata që e kam parë. Është mirë me mbajtë një takim edhe me komunitetin atje, është proces i rëndësishëm, shumë është i rëndësishëm. Kështu që më mirë...

Dafina Alishani: edhe a s'bën me bë një dëgjim publik krejt qata që s'kanë pasur mundësi...

Kujtim Gashi: Se di sa vlenë këshillat, lagjet kanë këshilla...

Egzona Hoxhaj: S'po vjen kërkush.

Dafina Alishani: Qaty e kanë mundësinë edhe kuvendarët që mos të jetë tani me ardhë prapë këtu me rekomandime ose...

Kujtim Gashi: Po bënë edhe ajo në fund.

Dafina Alishani: Në fund me pas një thirrje edhe kuvendarët edhe qytetarët.

Kujtim Gashi: Krejt kjo mundet me u kryer brenda dy javëve, 10 ditë, unë ju ndihmoj.

Kujtim Gashi: Ok faleminderit. Obligim e ke përderisa drejtori juaj s'është tuj punu.

Kujtim Gashi: U kry, unë ju ndihmoj. Hizin e kemi këtu, ai me këshillat është në kontakt, i thërrasim kur doni javën e ardhshme edhe ju njoftojmë.

Bajram Kastrati: Mundësisht edhe përfaqësuesi juaj le të jetë në takim Fil.

Kujtim Gashi; Ani vjen Fili.

Bajram Kastrati: Po ju drejtohem juve adin se keni një përgjësi keni përgjegjësi më të madhe a po kupton se...

Karanfil Haxhillari: Bajram, katër vjet jena marrë a e din, në pikë të pandemisë më është dashur me mbajt tubimin, e njoh ndjeshmërinë e këtij rasti. Unë po ju kuptoj që tash vetëm emra rezervë, këta s'kanë me u vendos.

Egzona Hoxhaj: Këto ban vaki nuk vendosen hiç.

Karanfil Haxhillari: Unë po e kuptoj këtë, por ama ke me hap një varg a po kupton, një plagë që është që 10 vjet.

Bajram Kastrati: E çka me bë Fil, me lënë qashtu?

Karanfil Haxhillari: Le të bëhet qysh duhet a e din, edhe këto propozimet rezervë bëhen qysh duhet. Në fund të ditës si anëtar i komisionit, i thuash kryetari i bashkësisë tënde lokale u dashtë me ju thirrë si bashkësi lokale juve me ju vetë sepse kjo s'ka ndodhur në 2015.

Bajram Kastrati: Qartë.

Bajram Kastrati: A po kupton? në këtë rast ti je pastër edhe pse edhe unë e kam propozim për shembull Faridin Tallafarriin e kisha propozu qysh tash si emër i rrugës me një bigrafi a po kupton? po që unë e kisha propozuar me shumë dëshirë po s'më ka vetë kërkush.

Bajram Kastrati: Mirë atëherë ne po e shtyjmë këtë edhe në momentin kur i ftojme përfaqësues lokal, nëse keni hapësirë, me bëjmë publike sigurisht edhe ftesën, nëse keni hapësirë me marrë pjesë edhe ju si anëtarë të KPF-së ish kanë mirë.

Kujtim Gashi: Qe ftesën e bëjmë tash menjëherë mas këtij takimit.

Antigona Bytyqi: Edhe kur ta shoh në anën tjetër secilin prej neve e kemi nga një kryetar kështu të këshillave, të fshatrave të lagjeve,

Levent Bush: vetëm na se kemi.

Antigona Bytyqi: Ke qenë anëtar i Komisionit. Me sa e pash krejt jeni të pajtimit për me e lanë për mbledhje tjetër.

Bajram Kastrati: Kryesuese veç edhe diçka. Prej zotit Adem e kam pasur një propozim që me mbajti një takim, një debat ndoshta. A mundesh Adem me na cekë praktikisht.

Adem Kollari (Përf. i OSBE): Përsëritje të gjithëve. Nuk është e zakonshme unë ti drejtohem KPFsë, mirëpo uroj të më konsideroni si mik. Pra propozimi ka qenë me zotëri Bajramin që të bisedojmë për me e bë procesin sa më gjithëpërfshies, konkretisht me u dakorduar për do parimet udhëheqëse të nominimit, cilat janë disa parime mbas të cilëve mund të nominojmë anëtarët? edhe në këtë vazhdë gjithashtu kemi propozuar një formular të nominimit. Çfarë ka qenë parimi më kryesor është që procesi të jetë i hapur për të gjithë, kushdo që ka një nominim, një person që është meritues për me e pas emrin ka qenë formulari për nominim me detaje të personit në fjalë edhe me biografinë edhe me nominu komisionit për shqyrtim dhe pastaj me përzzgjedh, kjo ka qenë ideja për një puntori me i biseduar. Për më tepër edhe një parim tjetër që ka qenë me rëndësi e uroj që ta merni parasysh është që t'i jepet pak më shumë hapësirë të nominuarve femra, sepse me përqindje të nominuerit e femra janë shumë shumë më pak se sa është femra.

Karanfil Haxhillari: Edhe obligim ligjor që duhet një përqindje, është 30%.

Bajram Kastrati: Mirë, a mendoni që ja vlenë me mbajtë një punëtori.

Kujtim Gashi: Tash e dakordojmë me OSBE-në.

Antigon Bytyqi: Me sa e pash të gjithë jemi për me e shty për një mbledhje tjetër, ju faleminderit të gjithëve. Atëherë e heqim këtë pikë për mbledhjen për nesër. Kalojmë te pika e pestë.

Pika e pestë:

Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;

Antigon Bytyqi: Po Gjafë, fjala për juve përsëri.

Gjafë Ponik (DEF): Raporti financiar për periudhën janar-mars, domethënë dihet se buxheti i komunës për vitin 2025 është 70.583.720.00 euro. Prej tyre për këtë tre mujosh janë shpenzuar 18.960.987.00 euro, apo me përqindje rreth 26% e buxhetit të planifikuar. Sa i përket të hyrave vetanake, domethënë janë të planifikume për vitin 2025, 10.600.00 euro, prej tyre janë inkasuar deri tash rreth 1.800.00 euro apo dikund 17% është domethënë inkasimi i këtyre mjeteve. Nëse keni pyetje rreth këtij raporti domethënë financiar mujmë me diskutu.

Kujtim Gashi: S'ka kamera tash mos u mërzi, Dafina s'fol pa kamera.

Antigona Bytyqi: A doni dikush fjalë me marrë?

Adem Shabanaj: S'votohet ky raport.

Antigona Bytyqi: Me ju rekomandu mbledhjes duhet.

Kujtim Gashi: Në KPF votohet.

Antigona Bytyqi: Kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. po kalojmë te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraparak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;

Antigona Bytyqi: Nuk e di a nevojë përsëri Bashkimi me marrë fjalën?

Karanfil Haxhillari: Shpresoj që të na dërgon në e-mail material.

Antigona Bytyqi: Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes? gjashtë për, zero kundër dhe një abstenim. Edhe pika e shtatë.

Pika e shtatë;

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit vlerësues;

Antigona Bytyqi: Prezent jemi tetë. Kush është për? gjashtë jemi për, zero kundër dhe një abstenim. Atëherë edhe kjo i rekomandohet mbledhjes. Faleminderit për prezencën, shihemi në mbledhje.

Përfundoi në ora: 11:16 minuta



**Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi**

Bytyqi